



## PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2011

I DETYRUAR

### SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI **A**

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkolla e mesme artistike; koreografike; sportive; me kohë të shkurtuar

*Udhëzime të përgjithshme:*

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

**PJESA I****Ismail Kadare****Fund Vjeshte**

Pyetja 1	D	1 pikë
Pyetja 2	A	1 pikë
Pyetja 3	C	1 pikë
Pyetja 4	A	1 pikë
Pyetja 5	B	1 pikë
Pyetja 6	D	1 pikë
Pyetja 7	B	1 pikë

**Pyetja 8**                    **1 pikë****Model përgjigjeje**

*Detaji:* sjellin brymën, ose ruan ditët e fundit nga dimri.

- 1 pikë**                    Nëse nxënësi shkruan njërin nga detajet më lart..  
**0 pikë**                    Nëse përgjigjja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

**Pyetja 9**                    **2 pikë****Model përgjigjeje**

a) Nënteksti mund të lidhet: *me pastërtinë shpirtërore, qetësinë shpirtërore, ditët e rinisë, ditët e lumtura, naivitetin e moshës, çiltërsinë dhe cilësi të tjera të moshës, kohës* etj.

b) figura: *metafora, epiteti.*

- 2 pikë**                    Nëse nxënësi shpjegon kuptimin e vargut dhe gjen figurën letrare.  
**1 pikë**                    Nëse nxënësi jep vetëm njërin nga dy përgjigjet.  
**0 pikë**                    Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Shënim:**

*Nxënësi do të marrë pikë të plota ose të pjesshme për pikën a), në çdo rast tjetër kur përgjigja e tij i afrohet logjikës së pyetjes dhe modelit të përgjigjes së dhënë në skemë.*

**Pyetja 10**                    **3 pikë****Model përgjigjeje**

a) rima: *e larmishme*. Për secilën strofë rimojnë vetëm *dy vargje të saj*, duke i dhënë rimës lidhje të brendshme, ritëm.

b) strofa: *katërshe*

c) *fiton muzikalitet, ritëm, rregullsi, harmoni* etj.

- 3 pikë** Nëse nxënësi jep tri përgjigje si më lart.  
**2 pikë** Nëse nxënësi jep dy nga përgjigjet si më lart.  
**1 pikë** Nëse nxënësi jep vetëm një nga përgjigjet më lart.  
**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Shënim:**

*Nxënësi do të marrë pikë të plota ose të pjesshme për pikën a) dhe c), në çdo rast tjetër kur përgjigja e tij i afrohet logjikës së pyetjes dhe modelit të përgjigjes së dhënë në skemë.*

## Pyetja 11                      3 pikë

**Model përgjigjeje**

- a) mjeti gjuhësor është **përemri** që del në format: *të tua, ti, Ne*.
- b) heroi lirik me dialoguesin e tij vendos një marrëdhënie *të ngrohtë, të ndërvarur, përfshirëse, e percepton si shoqëruese të tijin, bashkëpërjetues të atmosferës që sjell stina*, etj.
- c) shembull: Po **ti** eja, atje të shkojmë, (mund të merren edhe vargje të tjera, nga strofa tre dhe katër).

- 3 pikë** Nëse nxënësi gjen përemrin, shpjegon marrëdhënien dhe jep shembullin.  
**2 pikë** Nëse nxënësi shkruan vetëm dy nga përgjigjet a) b) c).  
**1 pikë** Nëse nxënësi shkruan vetëm një nga përgjigjet a) b) c).  
**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Shënim:** *për pikën b) dhe c) do të pranohen variante përgjigjesh të tjera të përtaqura me skemën, mjafton që ato të afrojnë me logjikën e pyetjes dhe të jenë të formuluar qartë.*

## Pyetja 12                      3 pikë

**Model përgjigjeje**

- a) *krifë + i verdhë, ose e përbërë*.
- b) *flokët*
- c) fjala sjell *imazhe të stinës së vjeshtës*, vjeshtës në fundin e saj kur ngjyra e verdhë *mbizotëron*. Por në marrëdhënie me heroin dhe ndjesitë e këtij heroi në poezi, ky imazh mund të lidhet edhe me imazhin e *flokëve të vajzës*. Flokët e saj dhe flokët e vjeshtës, etj.

- 3 pikë** Nëse nxënësi jep fjalëformimin, sinonimin dhe shpjegon imazhin.  
**2 pikë** Nëse nxënësi gjen vetëm dy nga tri përgjigjet më lart.  
**1 pikë** Nëse nxënësi gjen vetëm një nga përgjigjet më lart.  
**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Shënim:**

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë për pikën c) jep shpjegime dhe formulime të tjera, por që afrojnë me logjikën e pyetjes dhe të përgjigjes së dhënë në skemë.*

## Pyetja 13 8 pikë

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

### **KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË 2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përshkruan një stinë dhe ndjesinë që shkakton ajo.
- shpreh marrëdhënien e tij me këtë stinë.
- vendos raporte paralelizmi midis tij dhe stinës.
- i referohet poezisë apo gjendjes së tij personale në një situatë të ngjashme.
- përdor detaje përshkruese.
- përdor figura letrare
- përshkrimi ka ritëm dhe larmi këndvështrimesh.
- etj.

### **KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË 2 pikë**

#### **1 pikë Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:  
hyrjen  
zhvillimin  
përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

#### **1 pikë Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme).

### **KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI 2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike.
- ka fjalor të pasur.
- stil origjinal.

### **KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE 2 pikë**

#### **(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore.
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta.
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.
- ka saktësi drejtshkrimore.

**PJESA II****EURIPIDI****Medea (fragment)**

Pyetja 14	D	1 pikë
Pyetja 15	A	1 pikë
Pyetja 16	D	1 pikë
Pyetja 17	C	1 pikë
Pyetja 18	B	1 pikë
Pyetja 19	A	1 pikë

**Pyetja 20 3 pikë****Model përgjigjeje**

- a) Situata e Medeas *është e vështirë*. Ajo ndihet *fatkeqe, e fyer, e nëpërkëmbur, e mjerë, e mbushur plot dhimbje, inat, urrejtje*, etj.
- b) dhe c) *për shkak të dëbimit, s'i ka mbetur më asnjë mik, hyjtë nuk e përkrain, mendon për hakmarrjen*, etj.

- 3 pikë** Nëse nxënësi perifrazon gjendjen e Medeas dhe jep dy arsye për këtë.
- 2 pikë** Nëse nxënësi përshkruan ose perifrazon vetëm gjendjen e Medeas së bashku me një arsye. Nëse nxënësi jep vetëm të dy arsyet pa e përshkruar ose perifrazuar gjendjen e Medeas.
- 1 pikë** Nëse nxënësi jep vetëm gjendjen e Medeas ose vetëm njëren nga arsyet.
- 0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Shënim:**

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një arsye ose perifrazon gjendjen e Medeas në atë mënyrë që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që afron me logjikën e pyetjes dhe që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 21 3 pikë****Model përgjigjeje**

- a) Roli i korit në të gjithë veprat dramatike është *mbështetës, paralajmërues, shtytës i veprimit, tregues i emocionalitetit skenik*, etj.
- Në këtë fragment kori, *mbështet* Medean, i ofron spektatorit situatën e saj, *e qartëson* këtë situatë, *për të motivuar më vonë hakmarrjen* e saj. Por kori këtu konsiderohet edhe *element ndihmës*, për të kuptuar se çfarë po ndodh, *paralajmëron*, etj.

- b) *Grua fatkeqe!*

- c) Personazhet e veprave të antikitetit në veprimet e tyre *udhëhiqeshin nga perënditë*. Fati i personazheve varej nga Hyjtë.

- 3 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet për pikën a) b) c).
- 2 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet vetëm për dy nga pikat më lart.
- 1 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet vetëm për një nga pikat më lart.
- 0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Shënim:**

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por afron me logjikën e pyetjes dhe që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 22**      **3 pikë****Model përgjigjeje**

a) hakmarrja, motivi i hakmarrjes.

b) *sot të tre armiqtë do t'i shtrij të vdekur:*

c) **Konsiderohet pika më e lartë e dramacitetit të fragmentit sepse:**

duke ndjekur logjikën e veprimit dhe ngjarjes që jepet në fragment ajo kalon nëpër këto faza: *dhimbja e Medeas ose gjendja e saj e rënduar, Medea hileqare dhe, në fund, plani i hakmarrjes. Hakmarrja e saj është thelbi i gjithë tragjedisë, kështu që thurja e panit që të shpie atje shënon edhe pikën kulmore të këtij fragmenti.*

- 3 pikë**      Nëse nxënësi jep tri përgjigjet si më lart.  
**2 pikë**      Nëse nxënësi jep dy nga përgjigjet më lart.  
**1 pikë**      Nëse nxënësi jep vetëm një të një nga përgjigjet më lart.  
**0 pikë**      Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Shënim:**

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, bën një shpjegim që nuk e përmban modelin e përgjigjes, por që ka lidhje me logjikën e pyetjes dhe që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 23**      **2 pikë****Model përgjigjeje**

a) sot

b) ndajfolje

- 2 pikë**      Nëse nxënësi gjen fjalën dhe pjesën e ligjëratës.  
**1 pikë**      Nëse nxënësi jep vetëm një të një nga përgjigjet.  
**0 pikë**      Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 24**      **3 pikë****Model përgjigjeje**

- a) **gjendja e parë:** Medea e mjerë e mbushur plot dhimbje dhe që s'ka asnjë mbështetje. (mund të jepet edhe me shembull nga fragmenti si p.sh: *keq për mua nga të gjitha anët*).
- b) **gjendja e dytë:** Medea hileqare. Bën gjithçka për t'i shpëtuar dëbimit dhe për të realizuar planin e saj madhor.
- c) **gjendja e tretë:** Medea e vendosur të realizojë planin e saj të hakmarrjes.

- 3 pikë**      Nëse nxënësi jep tri gjendjet si më lart, por nëpërmjet formulimeve individuale.  
**2 pikë**      Nëse nxënësi jep dy gjendje.  
**1 pikë**      Nëse nxënësi jep vetëm një të një prej tyre.  
**0 pikë**      Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Shënim:**

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, bën një formulim që i afron modelit të përgjigjes, që ka lidhje me logjikën e pyetjes dhe që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 25**                      **3 pikë****Model përgjigjeje**

a)dhe b)

**Tipare:** plot pasione ekstreme, hakmarrëse, hileqare, e mjerë, plot dhimbje, xheloze, e vendosur,etj.

c) *Fati i saj në fund është i lidhur me natyrën dhe karakterin e saj.* Hakmarrja realizon egon e saj, por në fund të fundit i merr jetën njerëzve që ajo kishte dashur më shumë.

**3 pikë**                      Nëse nxënësi jep dy cilësi dhe argumentimin.

**2 pikë**                      Nëse nxënësi jep një cilësi dhe argumentimin ose vetëm dy cilësi të Medeas.

**1 pikë**                      Nëse nxënësi jep vetëm një cilësi ose vetëm argumentimin.

**0 pikë**                      Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Shënim:**

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, bën një argumentim ose përcaktim që i afron modelit të përgjigjes, që ka lidhje me logjikën e pyetjes dhe që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

---